

KONTRATE

Date: 10.04.2026.

KUVENDI I KOMUNES DRAGASHI, (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njëren anë; dhe

ARMIRING SH.P.K., Lagjja Stolliqi pn, Ngucat, Malishevë, Malishevë, 811858656 (në vazhdim "Operatori Ekonomik"), ne anën tjetër, janë pajtuar te lidhin një kontrate publike për:

002-Riparimi I rrugës se bjeshkës në pjesën e dëmtuar në fshatin Bresanë me numër Identifikues 621-26-1496-2-3-6

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës do të jetë **Riparimi I rrugës se bjeshkës në pjesën e dëmtuar në fshatin Bresanë** me numër Identifikues 621-26-1496-2-3-6, dhe nr, te mbrendshem 621-2025-002-236.

1.2 Kontrata hynë në fuqi me 14.04.2026. dhe përfundon me 03.05.2026. (nese lejojne kushtet atmosferike gjithemon, dhe jep urdher per pune menagjeri i kontrates)

1.3 Afati kohor i performances nuk mund të jetë më shumë se 5 ditë nga data e marrjes së urdhëreses.

1.4 Vendi i kryerjes së shërbimeve do të jetë fshati **Bresanë**

1.5 Incotermi i aplikueshëm do të jetë DDP¹ (Detyra e Dërguar e Paguar).

Menagjer i kontrates nga AK eshte :Ylli Qafleshi

Mbikqyres i drejteperdrejt i menagjerit te kontrates eshte: Raisa Shabani Jellmazi

Menagjer i projektit nga OE eshte:Bledar Krasniqi

¹ DDP – Detyra e Dërguar e Paguar- Incoterms 2010 Oda Ekonomike Ndërkombëtare

Neni 2 Ligji i aplikueshëm

2.1 Ligji i zbatueshëm do të jetë sipas Nenit 40 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 Për çështjet që nuk mbulohen me dispozita të kontratës, zbatohen ligjet në fuqi në Kosovë. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.

Neni 3 Çmimi

3.1 Çmimi total i kontratës do të jetë: **4, 385.00 €** (kater mij e treqind e tetedhjetë e pese Euro).

3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Operatorit Ekonomik sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve gjatë ekzekutimit të kontratës (në përjashtim të çmimeve të atyre artikujve që i nënshtrohen ndryshimit të çmimit sipas berzës përkatëse, nëse aplikohet).

Neni 4 Pagesat

4.1 Pagesa do të bëhet në Euro.

Sipas realizimit të punimeve, të përcjellura me raport nga ana e Menaxherit të projektit dhe komisionit të pranimit.

4.2 Pagesat e detyrimeve sipas një fature të lëshuar nga Operatori Ekonomik duhet të paguhet brenda jo më shumë se 30 ditësh nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

Neni 5 Marrëveshjet lidhur me tatimin dhe doganën

5.1 Operatori Ekonomik është përgjegjës për të gjitha detyrimet dhe taksat në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Të gjitha taksat dhe detyrat e tjera doganore konsiderohen se janë të përfshira në çmimin e kontratës.

Neni 6 Kualiteti

6.1 Kualiteti i **[shërbimeve]** duhet në të gjitha aspektet të plotësoj specifikimet teknike të parashtruara në Dosjen e Tenderit.

Neni 7 Garancioni

7.1 Garancioni ne kete aktivitet nuk aplikohet

Neni 8 Vonesat në ekzekutim

8.1 Nëse Operatori Ekonomik me përgjegjësinë e tij nuk arrin [të realizojë ndonjë ose te gjitha shërbimet] brenda limiteve kohore të specifikuar në kontratë, Autoriteti Kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së [shërbimeve] të pa dorëzuara deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të kontratës.

Neni 9 Inspektimi dhe testimi

9.1 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë që herë pas here të inspektojë, kontrollojë, masë dhe testojë komponentët, materialet, dhe mjeshtërinë, dhe të kontrollojë përparimin e përgatitjes, fabrikimit apo prodhimit të çfarëdo artikulli që përgatitet, fabrikohet ose prodhohet për t'u dorëzuar sipas kontratës, në mënyrë që të përcaktojë nëse komponentët, materialet dhe mjeshtëria kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar.

Neni 10 Nën-kontraktimi

10.1 Një nënkontratë do të jetë e vlefshme vetëm nëse është një marrëveshje me shkrim me të cilin Operatori Ekonomik i beson kryerjen e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë. Operatori Ekonomik nuk duhet të nënkontrakttojë pa autorizim paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Autoriteti Kontraktues do të njoftojë Operatorin Ekonomik për vendimin e tij brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi.

Neni 11 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues

11.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Operatorit Ekonomik shtatë ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet në vijim: a) Kur operatori ekonomik nuk arrin t'i realizoj obligimet e veta sipas kontratës; b) Dështon në ekzekutimin e kontratës në afatin e caktuar; c). Refuzon urdhrat administrativ të autoritetit kontraktues; d) Ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga autoriteti kontraktues; e). Falimenton; f). Është dënuar nga një gjykatë për një shkelje që ka të bëjë me sjellje profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res-judicata*; g) Operatori ekonomik i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjetër ilegal që i dëmton interesat e përgjithshme financiare; h) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës.

Neni 12 Ndërprerja e Kontratës nga Operatori Ekonomik

12.1 Operatori Ekonomik, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin Kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues: a) Nuk arrin t'i paguajë Operatorin Ekonomik shumën që duhet të paguhet brenda periudhës së saktësuar me kontratë; b) vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta me kontratë; c) si rezultat i forcës madhore, Operatori

Ekonomik nuk është në gjendje për të kryer një pjesë materiale të kontratës për më shumë se 180 ditë, për arsye që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk i atribuohen të Operatorit Ekonomik.

Neni 13 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

13.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë ose vendim nga gjyqi, ose vendim arbitrimi.

13.2 Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në [specifiko gjykatën kompetente] në pajtim me ligjin e Kosovës.

Neni 14 Komunikimi

14.1 Çdo komunikim me shkrim në lidhje me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Operatorit Ekonomik duhet jap Titullin e kontratës dhe numrin e identifikimit, dhe duhet të dërgohet me postë, faks, e-mail ose me dorë.

E hartuar në gjuhën [Shqip] [Serbisht] [Anglisht]² në tri origjinale, dy origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Operatorin Ekonomik.

Për Operatorin Ekonomik

Për Autoritetin Kontraktues

Emri:	ARMIRING SH.P.K., Lagjja Stolliqi pn,Ngucat,Malishev ë, Malishevë, 811858656	Emri:	Fadil Sinani
Pozita:	DREJTOR	Pozita:	U-D-Zyrtar përgjegjës i prokurimit
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	14.04.2026.	Data:	14.04.2026.
Vula:		Vula:	

² Gjuha do të jetë gjuha e përdorur nga tenderuesi në tenderin e tij.

ARMIRING

PARAMASA DHE PARALLOGARIA PËR PROJEKTIN:
RIPARIMI I RRUGËS SË BJESHKËS NË PJESËN E DËMTUAR NË FSHATIN BRODOSANË

A FURNIZIMI ME MATERIALE					
Pos	Përshkrimi i pozicioneve	Njësia	Sasia	Çmimi me TVSH-€	Shuma-€
1	Shënimi i lokacionit dhe shenjëzimi i vendosja , piktimi dhe percatimi i trase se rruges.	m'	90.00	0.50 €	45.00 €
2	Germimi i dheut me makineri, si dhe nivelizimi i trases se rruges konform niveletave nga projekti.	m2	400.00	1.00 €	400.00 €
3	Furnizimi, Transporti dhe Montimi i gypave ne pjesen e damtuar nga betoni i armuar fi 600mm, si dhe furnizimi me materialet e tjera dhe ndertimi i kokes dalese , nga betoni i armuar i leshesese, me te gjitha matreialet dhe punimet e tjera te nevojeshme.	copë	2.00	130.00 €	260.00 €
4	Furnizimi, transporti, shtrirja, nivelizimi dhe punimi i shtresës me gurë të thyer fraksion 0-64 mm me trashësi t=50cm, për pjesët e trasese se rruges , si dhe ngjeshja e tij me cilindër vibrues deri sa të fitohet moduli i ngjeshjes sipas standarteve.Llog në m³	m3	415.00	6.00 €	2,490.00 €
5	Furnizimi, transporti, shtrirja, nivelizimi dhe punimi i shtresës me gurë të thyer fraksion 0-32 mm me trashësi t=15cm, për pjesët e rruges , si dhe ngjeshja e tij me cilindër vibrues deri sa të fitohet moduli i ngjeshjes sipas standarteve.Llog në m³	m3	115.00	6.00 €	690.00 €
6	Germimi me makine i dhe dheut per hapjen e kanalit ansore te rruges si dhe largimi i dheut gjeri ne vend deponi.	m'	200.00	2.00 €	400.00 €
7	Pastrimi i leshesave ekzistuese nga guret dhe dheu, si dhe funksionalizimi i tyre ,	copë	2.00	50.00 €	100.00 €
TOTALI:					4,385.00 €

REKAPITULLIMI I PËRGJITHSHËM

A FURNIZIMI ME MATERIALE		4,385.00 €
TOTALI me TVSH:		4,385.00 €





Republika e Kosovës
Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Dragashit / Opština Dragaš / Dragas Municipality



02 - Kryetari i Komunës
Nr. 400/01-6206/26
Dt.08.04.2026
Dragash

Kryetari i Komunes,në bazë të nenit 13 të Ligjit Nr. 03/L-40 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28/2008), si dhe në pajtim me nenin 81 të Ligjit Nr.04/L-042 për Prokurim Publik në Republikën e Kosovës,si dhe Rregullave dhe Udhezuesit Operativ për Prokurim Publik/Nr, A01, nxjerre:

V E N D I M

Caktohet menaxheri i kontrates dhe mbikqyresi në realizimin e kontrates për **002-Riparimi I rrugës së bjeshkës në pjesën e dëmtuar në fshatin Bresanë** me numër Identifikues **621-26-1496-2-3-6**, dhe nr, të mbrendshëm **621-2026-002-236**.

Ylli Qafleshi -caktohet menagjer I kontrates,

Raisa Shabani Jelmazi-Mbikqyres I drejteperdrejt I menagjerit te kontrates

Menaxheri I kontrates,obligohet qe te hartoje nje plan te menaxhimit te Kontrates,duke perdorur formularin standard te miratuar nga KRPP, I cili duhet te nenshkruhet nga ana e te dy paleve(Menaxherit te Kontrates se AK dhe Menagjerit te Kontrates se OP) para inicimit te zbatimit te kontrates dhe nje kopje te nenshkruar te planit per menaxhimin e kontrates do ta percjelle tek departamenti I prokurimit.

1. Menagjeri I kontrates e menagjon kontraten deri ne pranimin e plote te puneve te kerkuara-kontraktuara, respektivisht deri ne permbylljen e kontrates.
2. Ky vendim hyn ne fuqi dite e nenshkrimit

Kryetari I Komunes:

Bexhet Xheladini



Vendimi u dërgohet:menagjerit te projektit,
Mbikqyresit te kontrates,
Zyres se Prokurimit,
Drejtorit te Drejtorise perkatese,
Arkivit te Komunes(kryetarit).